



Ne baze te nenit 12, paragrafi 1 dhe 2, shkronja (d), lidhur me nenin 14 dhe 17, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008”, e në mbështetje të nenit 22, të Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 10/2019”, e konform nenit 27 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe nenit 15, lidhur me nenin 29, pika 2 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën,-----, miratoi këtë:

Projekt-V E N D I M

Neni 1

Formohet komisioni për mbikëqyrjen e zbatimit të kontratave për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme të Komunës në **“Zonën industriale”** në Shirok dhe **“Agro-zonës industriale”** në fshatin Samadrexhë, se përfituesit konkretisht shfrytëzuesit e pronës së paluajtshme të Komunës, a janë duke e zbatuar kontratën sipas planit dinamik realizues dhe ligjeve të aplikueshme në Republikën e Kosovës dhe dispozitave ligjore të parapara në kontratë, në këtë përbërje:

- 1.1 -----kryesues/e
- 1.2 -----anëtar/e
- 1.3 -----anëtar/e
- 1.4 -----anëtar/e
- 1.5 -----anëtar/e

Neni 2

Detyrë e këtij komisioni është që të bënë mbikëqyrjen e zbatimit të kontratave se përfituesit që kanë marr pronën e paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë, a janë duke e zbatuar kontratën, sipas planit dinamik realizues dhe konform ligjeve të aplikueshme në Republikën e Kosovës dhe dispozitave ligjore të parapara në kontratë.

Neni 3

Në rase komisioni konstaton parregullsi në zbatimin e kontratave i njëjti harton raportin për ecurinë e zbatimit të planit dinamik si dhe realizimin e kontratës si tërësi dhe ti rekomandon Kryetarit të Komunës për veprimet të mëtejshme për marrjen e masave përkatës në rast të mos përmbushjes së kontratës nga përfituesi.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS– SUHAREKË

01-Nr-_____
Më datë_____

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI